



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT

*Seksioni për organet e administratës qendrore, të pushtetit vendor
dhe të të tretëve që veprojnë për llogari të tyre*

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

[Tel/Fax: +355 4 2380 300/315](tel:+35542380300315)
[E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. **Prot.**
Nr. Dok. 202502117/

Tiranë ____/____/2025

Lënda: *Rekomandim për ushtrimin e kompetencave ligjore të Inspektoriatit të Mbrojtjes së Territorit, në Bashkinë Lushnjë, në trajtimin e ankesës së shtetasit L. S.*

Drejtuar: **Inspektoriatit të Mbrojtjes së Territorit,
në Bashkinë Lushnjë**

Lushnjë

Të nderuar,

Në ankesën drejtuar kryetarit të Bashkisë Lushnjë dhe për dijeni Avokatit të Popullit, shtetasi L. S., banor në Lushnjë, ka shprehur shqetësimin në lidhje me mosveprimin e vazhduar të organit tuaj publik, për një problematikë të krijuar nga hapja e një lokali brenda pallatit të banimit, në pronësi të shtetasit T. K. .

Sikundër ai shkruan, ky lokal ka katër dyer plus edhe dy dyer dyqani, të cilat janë hapur brenda hyrjes së z. L. S., ngjitur me njëra tjetrën, në kundërshtim me ligjin dhe me ndërrim destinacioni. Lidhur me këtë fakt z. L. S. kërkon mbylljen e tyre, pasi është edhe në konflikt gjyqësor me z. T. K. .

Në vazhdim z. L. S. kërkon që, dera e parë e lokalit që është nga ana e dritareve të banesës së tij të mbyllet dhe lokali të punojë me tre dyert e tjera, pasi për arsye shëndetësore nuk duron dot zhurmat e njerëzve që vijnë aty. Ai shprehet se, vuan nga zemra dhe shëndeti i tij rëndohet nga zhurma e klientëve që ulen para dritareve të banesës së tij, ku është vendosur edhe një çadër.

Nga ana tjetër, z. L. S. kërkon lirim të hapësirave publike, pasi shkruan se është rrethuar dhe zënë trotuari me një gardh, hyrjen e të cilit e kanë lënë sërish para dritareve të banesës së tij. Lidhur me ndërhyrjen në strukturën e pallatit për shkak të prishjes së mureve mbajtës

dhe ndarës për ndërtimin e lokalit, z. L. S. ka kërkuar një inspektim për këtë problematikë në përputhje me legjislacionin në fuqi, pasi pallati ku gjendet lokali dhe ku banon edhe ai, me strukturë tulle dhe pa kolona.

Së fundmi, z. L. S. ka kërkuar heqjen e prozhektorëve që janë vënë në tokë para dritareve të tij, pasi ato janë të luajtshëm dhe bëjnë shumë zhurmë. Në këto rrethana ai ka kërkuar ndërhyrjen dhe veprimin e organit tuaj publik, për zgjidhjen e kësaj problematike ekzistuese.

Sa më sipër, duke qënë se Avokati i Popullit është njoftuar nga ana e kërkuarit lidhur me këtë çështje, pas marrjes dijeni për kërkesën e datës 04.03.2023, drejtuar kryetares së Bashkisë Lushnjë, kemi vendosur marrjen në shqyrtim të saj, në përputhje me paragrafin e parë, të nenit 13, të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar (ligji nr. 8454/1999), ku parashikohet se:

“Avokati i Popullit fillon procedurën e shqyrtimit të çështjes kur vëren ose dyshon se ka ndodhur një shkelje e së drejtës, në bazë të ankesës apo të kërkesës së personit të interesuar ose të dëmtuar, si dhe me nismën e vet, për raste të veçanta të bëra publike”.

Në zbatim të detyrimit kushtetues e ligjor dhe konkretisht, të paragrafit 4, të nenit 63, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku parashikohet se:

“Organet dhe funksionarët publikë janë të detyruar t’i paraqesin Avokatit të Popullit të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara prej tij”,

si dhe shkronjës “b”, të nenit 19, të ligjit nr. 8454/1999, ku parashikohet se:

“Në rastet kur vendos të kryejë hetime të pavarura, Avokati i Popullit ka të drejtë: b) të kërkojë shpjegime nga çdo organ i administratës qendrore dhe vendore, si dhe të marrë çdo dosje apo material që ka lidhje me hetimin”,

në vijim të hetimit administrativ me qëllim sqarimin e fakteve e të rrethanave, i jemi drejtuar me disa shkresa organit tuaj publik.

Më konkretisht, për sqarimin e kësaj ankese kemi kërkuar fillimisht nga ana juaj me shkresën tonë nr. K3/L6-2 prot., datë 19.03.2024, si dhe nga ana e Bashkisë Lushnjë, dërgimin e shpjegimeve lidhur me arsyet e mostrajtitimit në kohë dhe sipas afateve ligjore të kësaj çështjeje, si dhe të masave që do të merreshin nga ana juaj në vazhdim, për zgjidhjen përfundimtare të saj. Kemi kërkuar gjithashtu, dërgimin e një kopjeje të shkresës zyrtare me të cilën do ti jepej përgjigje ankuesit, lidhur me sa ai ka parashtruar në kërkesën e tij, të sipërcituar.

Në mungesë të përgjigjes suaj të pritshme, brenda afateve ligjore të parashikuara nga legjislacioni në fuqi, jemi detyruar të përsërisim kërkesën për shpjegime me shkresat tona nr. K3/L6-4 prot., datë 08.05.2024, si dhe nr. K3/L6-6 prot., datë 29.06.2024. Ndërkohë, për shkak të mosreagimit tuaj të vazhduar për dhënien e informacionit për këtë çështje iu jemi drejtuar me shkresën K3/L6-7 prot., datë 14.10.2024, ku kemi rekomanduar, ndër të tjera, marrjen e masave të menjëhershme për plotësimin e detyrimit ligjor, për dhënien e informacionit Avokatit të Popullit.

Në përgjigjen e dhënë prej jush, me shkresën nr. 8418/1 prot., datë 23.10.2024, na është sqaruar se gjatë kohës që ne kemi kërkuar informacion për këtë çështje, nëpërmjet

shkresave tona të sipërcituara, personeli i organit tuaj publik ka qenë i pezulluar nga detyra që nga data 05.03.2024, për një periudhë katër mujore.

Në vazhdim në këtë përgjigje jepet informacioni se objekti i z. T. K., është përshtatur si njësi shërbimi shumë vite më parë. Lidhur me pretendimet e ngritura nga ankuesi, në përgjigje thuhet se me shkresën nr. 4126/2 prot., datë 24.05.2024, Drejtoria Juridike, Prokurimeve dhe Aseteve, në Bashkinë Lushnjë, ka sqaruar Avokatin e Popullit për veprimet e ndërmarra nga Bashkia Lushnjë dhe të institucioneve të tjera përkatëse.

Duke iu referuar shkresës së sipërcituar të Drejtorisë Juridike, Prokurimeve dhe Aseteve, në Bashkinë Lushnjë, konstatojmë se kjo shkresë i është dërguar paraprakisht institucionit tonë gjatë zhvillimit të hetimit administrativ të kësaj çështjeje.

Në përmbajtjen e kësaj shkrese jepet informacioni telegrafik se Bashkia Lushnjë, ka inspektuar objektin në vend dhe ka shqyrtuar dokumentacionin e paraqitur nga z. T. K. .

Sipas kësaj shkrese, ankesat e cituara në shkresën nr. 2051 prot., datë 04.03.2024, nga z. L. S. nuk qëndrojnë, pasi ato nuk përbëjnë shqetësim për komunitetin në atë zonë dhe për çdo veprim të kryer për ushtrimin e aktivitetit të tij, z. T. K. ka vepruar në bazë të ligjit.

Bashkëlidhur kësaj përgjigjeje të Bashkisë Lushnjë, është dërguar një kopje e shkresave zyrtare, përkatësisht:

- Vendimi nr. 415 regjistri, datë 09.11.2005, “Për regjistrimin si person fizik privat”, të Gjykatës së Shkallës së Parë Lushnjë. Gjykata në dispozitivin e këtij vendimi, ka vendosur të regjistrojë si person fizik privat shtetasin T. K., në fushën “Riparim dhe shërbim lojra fëmijësh”.
- Informacion akt-verifikimi, datë 26.06.2014, i Administratorit të Rajonit nr. 3, të Bashkisë Lushnjë.
- Informacion mbi kërkesën e z. L. S., i mbajtur nga Administratori i Rajonit nr. 3 dhe përfaqësues të Policisë Bashkiake Lushnjë.
- Autorizim, datë 08.10.2015, dhënë z. T. K., nga kryetari i Bashkisë Lushnjë, për realizimin e punimeve të mirëmbajtjes (punime stukimi dhe kthim i fasadës në gjendjen e mëparshme), për një apartament të ndodhur në Lushnjë.
- Shkresa “Kthim Përgjigje”, datë 05.12.2017, e Drejtorisë Rajonale të Mjedisit, drejtuar subjektit “T. K.”.
- Deklaratë për kryerje punimesh, viti 2018, lëshuar nga shtetasi T. K. .
- Vërtetim për aktivitet ekonomik të hapur, lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.
- Procesverbal verifikimi, datë 15.02.2014, mbajtur nga punonjës të “ÇEZ Shpërndarje” sh.a. (kopje e pallexueshme).
- Procesverbal i inspektimit, viti 2018, i mbajtur nga Inspektoriati Shtetëror i Mjedisit dhe Pyjeve, (kopje e pallexueshme).
- Shkresa “Kthim përgjigje”, datë 15.02.2019, e Inspektoriatit të Mbrojtjes së Territorit (IMT), në Bashkinë Lushnjë, drejtuar z. L. S. , ku jepet qëndrimi mbi vendosjen e një aspiratori, dy kondicionerëve dhe disa pemëve të mbjella, nga z. T. K. .
- Shkresa “Kthim përgjigje”, e vitit 2021, e IMT-së në Bashkinë Lushnjë, drejtuar z. L. S. .

- Ankesa të z. T. K. , dhe informacion i datës 20.03.2019, drejtuar nga ky i fundit, Platformës së Bashkëqeverisjes, Komisarariatit të Policisë të Rrethit Lushnjë, Kryetarit të Bashkisë Lushnjë.

Bazuar në këtë informacion zyrtar, si dhe në pretendimet e ngritura nga ana e ankuesit, sjellim në vëmendjen tuaj faktin se çdo informacion zyrtar i dërguar nga ana e Bashkisë Lushnjë, lidhur me këtë çështje, përveçse mund të shërbejë si informacion paraprak sqarues për organe të tjera publike nuk mund të zëvendësojë dhe aq më pak të merret i mirëqenë, si një veprimtari verifikuese/kontrolluese në fushën e zhvillimit të territorit, e barasvlefshme me veprimtarinë e IMT-së në Bashkinë Lushnjë.

Sikurse mund të konstatohet lehtësisht, objekti i ankimit në ankesën e z. L. S., është i ndryshëm nga objekti i konstatimit apo informacionet përkatëse zyrtare, të dhëna në kopjet e shkresave dërguar bashkëlidhur shkresës nr. 4126/2 prot., datë 24.05.2024, të Drejtorisë Juridike, Prokurimeve dhe Aseteve, në Bashkinë Lushnjë.

Më konkretisht, z. L. S. ngre shqetësimin në lidhje me ekzistencën e katër dyerve plus edhe dy dyer dyqani, të cilat janë hapur brenda hyrjes së pallatit ku banon z. L. S., ngjitur me njëra tjetrën, në kundërshtim me ligjin dhe me ndërrim destinacioni.

Nga ana tjetër, z. L. S. kërkon lirinë e hapësirave publike, pasi shkruan se është rrethuar dhe zënë trotuari me një gardh, hyrjen e të cilit z. T. K. e kanë lënë sërish para dritareve të banesës së tij. Lidhur me ndërhyrjen në strukturën e pallatit për shkak të prishjes së mureve mbajtës dhe ndarës për ndërtimin e lokalit, z. L. S. ka kërkuar një inspektim për këtë problematikë në përputhje me legjislacionin në fuqi, pasi pallati ku gjendet lokali dhe ku banon edhe ai, me strukturë tulle dhe pa kolona.

I vetmi justifikim që evidentohet në përgjigjen tuaj për problematikën e ngritur në këtë ankesë është se objekti i z. T. K. , është përshtatur si njësi shërbimi shumë vite më parë.

Nisur nga përmbajtja e shkresës së sipërcituar të IMT-së në Bashkinë Lushnjë, drejtuar Avokatit të Popullit, konstatohet se informacioni i dërguar nga ana juaj është jo i plotë dhe i paqartë. Në këtë informacion mungon dërgimi i një kopjeje të praktikës dokumentare, të zhvillimit të procedurës së verifikimit dhe konstatimit më të fundit të kryer nga ana e inspektorëve të organit tuaj publik, bazuar në objektin e ankesës së z. L. S., në përputhje dhe në bazë të legjislacionit në fuqi për këtë çështje.

Në këto rrethana dhe nisur nga justifikimi i dhënë në shkresën tuaj, datë 23.10.2024, del e nevojshme kryerja e një analize të legjislacionit rregullator të fushës për të kuptuar bazueshmërinë e konkluzionit të nxjerrë nga ana juaj në këtë rast. Paraprakisht theksojmë se, për aq sa ankuesi ka ngritur si pretendime në ankesën e tij, një pjesë e tyre nuk janë objekt i punës suaj, ndaj edhe në këtë rekomandim do t'i referohemi pikërisht atyre pretendimeve që përbëjnë objekt të veprimtarisë së IMT-së, të Bashkisë Lushnjë.

Ligji bazë specifik që përcakton fushën e veprimit dhe kompetencat e Inspektoriatit të Mbrojtjes së Territorit, të njësive vendore është ligji nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, i ndryshuar (ligji nr. 9780/2007). Në nenin 2, të këtij ligji parashikohet se, objekti i tij është përcaktimi i organeve për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme, si dhe i përgjegjësi të tyre.

I përcaktuar si një nga organet e inspektimit ndërtimor, Inspektoriati i Mbrojtjes së Territorit, të njësisë vendore, ka si përgjegjësi të tij ligjore,¹ ushtrimin e kontrollit të territorit dhe zbatimin e ligjshmërisë së standardeve teknike e kushteve zhvillimore në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit, si dhe të atyre të parashikuara në ligje të tjera. E gjithë kjo veprimtari zhvillohet mbi bazën e proceseve verifikuese dhe vendimmarrjes sanksionuese, të parashikuara këto në legjislacionin në fuqi.

Ndër detyrat/kompetencat e përcaktuara në ligjin nr. 9780/2007, për inspektoriatin e mbrojtjes së territorit të njësisë vendore, në nenin 5, shkronjat “a”, “b”, “ç”, “d” dhe “dh”, përcaktohet detyrimi se gjatë ushtrimit të përgjegjësisë të parashikuara në nenin 4, (të po këtij ligji), ky inspektoriat merr masat e mëposhtme:

- a) vendos për përmbushjen e detyrimeve ligjore në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit;
- b) vendos gjoba, sipas llojit të shkeljeve të dispozitave ligjore në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit;
- ç) vendos pezullimin e punimeve/ndërtimeve në rastin kur një afat kohor paraprak është i nevojshëm për marrjen e vendimit për përmbushjen e detyrimeve ligjore në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit,
- d) vendos prishjen e ndërtimit të kundërligjshëm,
- dh) përgatit kallëzimin penal për veprat penale të konstatuara gjatë ushtrimit të kontrollit dhe e paraqet atë pranë organeve përgjegjëse, sipas legjislacionit në fuqi.

Këto kompetenca bëhen më të qarta nga përkufizimi i dhënë në paragrafin e fundit të këtij neni, ku parashikohet se:

“Fjala “ndërtim/punim”, sipas këtij neni përfshin ato procese dhe/ose objekte ndërtimore që ndërtohen instalohen në territor, me vendosje të palëvizshme apo të përkohshme, që zhvillohen në dhe/ose mbi tokë, çdo veprim/proces ndërtimi, qermimi, prishjeje, zgjerimi, riparimi, rinovimi, si dhe çdo ndërhyrje tjetër në territor ose strukturë dhe i referohet gjendjes aktuale, vëllimit të punimeve të kryera, përfshirë dhe/ose rrethime të kundërligjshme në çastin e ushtrimit të inspektimit”.

Në vazhdim, në nenin 12, pika 8, shkronja “c”, të ligjit nr. 9780/2007, parashikohet se:

“Inspektoriati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit dhe ai i njësisë vendore, për ushtrimin e përgjegjësisë dhe detyrave të parashikuara në këtë ligj, kanë të drejtë:

- c) **të përfshijnë në kontrollin e tij** prishjen e një ndërtimi ekzistues, ndërtimin apo punimet për ndërtimin e një objekti të ri, rikonstruksionin e objektit, riparimin e objektit, infrastrukturën tokësore dhe nëntokësore, si dhe **punimet/ndërtimet**, që paraqesin rrezik shembjeje, **me pasoja** për jetën dhe shëndetin e njerëzve dhe **mbi pasurinë e të tretëve**”.

Ndërkohë, në ligjin nr. 107/2014 datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, të ndryshuar, në nenin 3, pikët 20 dhe 21, si dhe nenin 39, pikën 1, parashikohet se:

“20. “Ndërtim është çdo objekt që ndërtohet ose instalohet në territor, me vendosje të palëvizshme apo të përkohshme, dhe që zhvillohet nën dhe/ose mbi tokë”,

¹ Neni 4, paragrafi i parë, i ligjit nr.9780 datë 16.07.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, i ndryshuar.

21. *“Ndërtim/punim pa leje”, janë ato procese dhe/ose projekte ndërtimore të kryera në mungesë të lejes së ndërtimit, deklaratës paraprake për kryerjen e punimeve ose të kryera në kushtet e lejes së shfuqizuar”,*

“1. Leja e ndërtimit është e nevojshme për çdo ndërtim, riparim, restaurim apo prishje të objekteve ekzistuese, instalim apo ngritje të ndërtimeve të përkohshme, me përjashtim të rasteve të parashikuara nga neni 41, i këtij ligji”.

Në nenin 51, pikat 1-3, të po këtij ligji, parashikohet se:

“1. Inspektimi ka për mision garantimin dhe mbrojtjen e interesit kombëtar për një zhvillim të drejtë dhe të qëndrueshëm të territorit, përmes parandalimit të punimeve dhe ndërtimeve të paligjshme, sipas këtij ligji dhe akteve të nxjerra në zbatim të tij, si dhe ndëshkimin e drejtë të kundërvajtësve, që shkelin dispozitat e këtij ligji.

2. Inspektimi për verifikimin e respektimit të kërkesave ligjore, sipas këtij ligji, kryhet në përputhje me këtë ligj, aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij dhe legjislacionit të zbatueshëm për inspektimin e ndërtimit në Republikën e Shqipërisë.

3. Autoritetet e inspektimit bashkëveprojnë dhe bashkërendojnë veprimet inspektuese ndërmjet tyre, si dhe me autoritetet e planifikimit, me qëllim rritjen e efektivitetit të inspektimit. Kur vihet në dijeni të fakteve, edhe pse ato mund të mos jenë brenda sferës së tij të juridiksionit dhe përgjegjësisë, çdo autoritet i inspektimit njofton menjëherë autoritetin tjetër përgjegjës ose të interesuar”.

Në një akt tjetër normativ dhe përkatësisht, në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit”, të ndryshuar, në nenin 1, parashikohet se:

“1. Kjo rregullore ka si objekt përcaktimin e kushteve dhe procedurave të detajuara për zbatimin e instrumenteve të drejtimit të zhvillimit dhe për përmbajtjen, strukturën dhe procedurën e miratimit të dokumenteve të kontrollit të zhvillimit.

2. Qëllimi i kësaj rregulloreje është përcaktimi i të drejtave dhe detyrimeve të autoriteteve të zhvillimit për ushtrimin e funksionit të kontrollit të zhvillimit të territorit, në përputhje me ligjin nr.107/2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, të ndryshuar, si dhe garantimi i përdorimit të sistemit elektronik të lejeve nga të gjithë aplikuesit dhe institucionet e përfshira, me qëllim thjeshtimin e procedurave dhe ofrimin e shërbimit me një ndalesë”.

Së fundmi, në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 894, datë 04.11.2015 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga Inspektoriati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit dhe ai i njësisë vendore” (VKM nr. 894/2015), në gjurmën “a”, të nenit 1, parashikohet se kompetencat e dhëna në këtë akt nënligjor për kryeinspektorët/inspektorët e Inspektoriatit të Mbrojtjes së Territorit të njësisë vendore, parashikohen në mbështetje të nenit 12, të ligjit nr. 9780/2007.

Në vijim në nënëgërmat “ii” dhe “iv”, të gjurmës “b”, të pikës 1, të VKM-së nr. 894/2015, parashikohet se:

“b) Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit pranë njësisë vendore:

- ii) kryen kontrollë në territorin administrativ të njësisë vendore, në bazë të planit mujor të punës, të miratuar nga kryeinspektori, si dhe në bazë të njoftimeve të marra nga institucionet qendrore, vendore dhe subjektet fizike e juridike;
- iv) *përfshin në kontrollin e tij punimin /zhvillimin/ndërtimin e një objekti të ri, prishjen e objektit, rikonstruksionin e objektit, riparimin e objektit, infrastrukturën tokësore e nëntokësore, si dhe prishjen e objekteve që paraqesin rrezik shembjeje, me pasoja për jetën e shëndetin e njerëzve dhe mbi pasurinë e të tretëve, në përputhje me ligjin nr. 107/2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, dhe me aktet e tjera ligjore e nënligjore në fuqi”.*

Bazuar në kompetencat që gëzon nga ligji IMT-ja, e Bashkisë Lushnjë, del e qartë se ky organ publik bazuar në njoftimin e vetë ankuesit, ka kompetencën e plotë të verifikimit në vend të ndërtimeve, apo punimeve të pretenduara si të kundërligjshme, të kryera në këtë rast nga shtetasi Tomorr Kolonja.

Konkluzioni i nxjerrë në shkresën tuaj se mosveprimi juaj përligjet nga fakti që, objekti i z. Tomorr Kolonja, është përshtatur si njësi shërbimi shumë vite më parë, jo vetëm që nuk qëndron, por në rastin më të mirë do të gjykohej nga ana jonë si një interpretim i gabuar i ligjit, i cili ka çuar në mosveprimin e organit tuaj publik.

Për më tepër edhe nga kopja e dokumentacionit zyrtar të dërguar bashkëngjitur shkresës, datë 24.05.2024, të Drejtorisë Juridike, Prokurimeve dhe Aseteve, në Bashkinë Lushnjë, përkatësisht shkresës, (data mungon) viti 2018, “Deklaratë për kryerje punimesh”, rezulton se punimet përkatëse janë kryer pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 9780/2007.

Bazuar në kompetencat e ngarkuara nga ligji, IMT-ja në Bashkinë Lushnjë, nuk provon të ketë ushtruar kompetencat ligjore në trajtimin dhe verifikimin e kësaj çështjeje. Kjo gjë del e qartë, pasi në përgjigjen tuaj dërguar Avokatit të Popullit, nuk është dërguar kopja e dokumentacionit zyrtar provues për procedurat e ndjekura dhe konstatimet përkatëse të nxjerra, pas inspektimit të kryer për këtë çështje, në përputhje me kompetencat përkatëse ligjore.

Mosveprimi nga ana e IMT-së të Bashkisë Lushnjë, për trajtimin e këtij rasti dhe lejimi i kësaj gjendjeje theksojmë se mund të përbëjë premisa të shkaktimeve të një dëmi të vazhduar, ndaj palës ankuese.

Nisur nga qëndrimi i mbajtur për këtë çështje nga ana juaj, theksojmë se jo vetëm që legjislacioni në fuqi i jep inspektorëve të organit tuaj publik mundësinë që të verifikojnë në terren ligjshmërinë e ndërtimit, apo punimeve ndërtimore tashmë të kryera, por kompetenca e tyre ligjore shkon edhe më tej, pasi është ky organ publik që shpesh njoftohet, apo i kërkohet që të prishë ndërtime të kundërligjshme, të cilat janë përfshirë paraprakisht në procesin e legalizimit, por për të cilat vendimmarrja nga organi kompetent publik ka qënë refuzuese, pra për përjashtim nga procesi i legalizimit. Kur sjellim në vëmendje këtë fakt kemi parasysh ndërtime të kundërligjshme, për të cilat është kryer vetëdeklarimi prej vitesh më parë, por për të cilat pas vendimit për përjashtim nga procesi i legalizimit është vendosur prishja e tyre. Kjo gjë ka ndodhur dhe do të vazhdojë të ndodhë në veprimtarinë tuaj, pasi është kompetencë e parashikuar ligjore e organit tuaj publik.

Në trajtimin e kësaj çështjeje, del e qartë se ka një mosveprim të dukshëm të vazhduar dhe shmangie në marrjen e përgjegjësisë institucionale, si dhe të ushtrimit të kompetencave që organi juaj publik gëzon në bazë të ligjit nr. 9780/2007.

Është mëse e ligjshme që të kërkohet gëzimin e të gjithë të drejtave që rrjedhin nga pronësia e ligjshme, por është e pafalshme që të bëhesh pjesë e shkeljes së këtyre të drejtave me mosveprimin e pajustificuar ligjërisht.

Zbatimi i ligjit dhe kompetencave që rrjedhin prej tij nuk duhet lejuar të bëhen çështje dëshire nga punonjësit, të cilëve iu ngarkohet kjo detyrë, pasi rigoziteti i kërkuar në këte drejtim bëhet gjithmonë shkak për kërkimin e përgjegjësiwe institucionale dhe individuale.

Ky mosveprim nuk jep imazhin e kërkuar të një organi publik në shërbim të qytetarëve, por të një organi publik që zvarrit zgjidhjen dhe bëhet shkak i shkeljes së të drejtave të ligjshme të individëve.

Për më tepër, konstatojmë se kjo mënyrë trajtimi e çështjes nuk respekton një nga parimet kryesore të veprimtarisë së administratës publike, të sanksionuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, por edhe në një sërë aktesh normative ndërkombëtare, parim ky që lidhet me të drejtën për procesin e rregullt ligjor dhe atë të marrjes së vendimeve.

Avokati i Popullit nuk inkurajon ngritjen e asnjë ndërtimi të kundërligjshëm, prandaj ndan qëndrimin se kjo kulturë mosreaguese ndaj ndërtimeve pa leje duhet të mbarojë!

Ky rekomandim shkon në të njëjtën linjë edhe me kërkesat e parashtruara në rezolutat e Kuvendit të Shqipërisë, për vlerësimin e veprimtarisë së Avokatit të Popullit, ku institucionit tonë i kërkohet adresimi i vazhduar i të gjitha çështjeve ku konstatohet keqadministrim nga ana e organeve publike.

Në procesin e ndërmjetësimit nga ana jonë për zgjidhjen e kësaj çështjeje duam t'iu kujtojmë përkufizimin tashmë të pranuar nga Parlamenti Evropian, në lidhje me keqadministrimin nga ana e organeve të administratës publike, sipas të cilit:

“Keqadministrimi ndodh kur një organ publik, nuk vepron në përputhje me një rregull apo princip, i cili është i detyrueshëm për të”.

Nga ana tjetër, në përputhje me pikën 2, të nenit 15, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, organet e pushtetit publik në përmbushje të detyrave të tyre duhet të respektojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe të kontribuojnë në realizimin e tyre dhe jo të bëhen shkak me mosveprimin e tyre, në vazhdimin e shkeljes dhe mosrespektimit të këtyre të drejtave.

Detyrimi për mbrojtjen e pronës dhe të drejtave që rrjedhin prej saj, sikurse edhe në këtë çështje, është parashikuar shprehimisht edhe në paragrafin e parë, të nenit 1, të protokollit 1, të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, ku parashikohet se:

“Çdo person fizik, ose juridik ka të drejtë për respektimin e pasurisë së tij. Askush nuk mund të privohet nga prona e tij, veçse për arsye të dobisë publike dhe në kushtet e parashikuara nga ligji dhe nga parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare”.

Për sa më sipër, në mbështetje të pikës 3, të nenit 63, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe të nenit 21/b, të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar, ku parashikohet se:

“Pas përfundimit të hetimeve, Avokati i Popullit...

- *paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që, sipas tij, ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive”,*

R E K O M A N D O J M Ë

1. *Ushtrimin nga ana e Inspektoriatit të Mbrojtjes së Territorit, të Bashkisë Lushnjë, të përgjegjësi, të përcaktuara në ligjin nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, të ndryshuar, si dhe në legjislacionin specifik rregullator në fuqi, për trajtimin e ankesës së shtetasit L. S..*
2. *Marrjen e masave për mospërsëritjen e kësaj praktike në të ardhmen, në procedurat administrative që do të ndiqen nga ana juaj për trajtimin e çështjeve të tjera, brenda juridiksionit dhe kompetencave të Inspektoriatit të Mbrojtjes së Territorit, të Bashkisë Lushnjë.*

Në përputhje me nenin 22, të ligjit nr. 8454 datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar, ku parashikohet se:

“Organet të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar një rekomandim, kërkesë apo propozim për shkarkim, duhet ta shqyrtojnë rekomandimin, kërkesën, apo propozimin për shkarkim dhe të kthejnë përgjigje brenda 30 ditësh, nga data e dërgimit të rekomandimit, kërkesës, apo propozimit për shkarkim.

Përgjigja duhet të përmbajë shpjegime të arsyetuara për çështjen në fjalë, si dhe çfarë veprimesh, mosveprimesh, apo masash ka ndërmarrë ai organ”,

lutemi të na vini në dijeni për qëndrimin tuaj, ndaj këtij rekomandimi.

Duke besuar në mirëkuptimin tuaj,

K O M I S I O N E R E

Erinda MELI